



RREGULLORE PËR PUNËN E BORDIT TË FSSHRK-së



Në bazë të pikës 6.5 të Statutit të Federatës së Sportit Shkollor, Bordi i FSSHRK-së, në mbledhjen e mbajtur më 13.10.2022, mori vendim për miratimin e rregullores së Këshillit Mbikqyrës për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta:

RREGULLORE PËR PUNËN E BORDIT TË FSSHRK-së

PËRMBAJTJA :

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME
2. PËRGADITJA DHE CAKTIMI I MBLEDHJËS SË BORDIT
3. MËNYRA E PUNËS SË BORDIT
4. PROCESVERBALI I BORDIT
5. MBAJTJA E RENDIT NË BORD
6. VENDOSJA NË BORD
7. ZGJEDHJA E SEKRETARIT TË FEDERATËS
8. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE



1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore parashihet puna e Bordit të Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës (në tekstin e mëtejme Bordi i Federatës) dhe atë:

- Përgatitja, thirrja dhe mbajtja e mbledhjeve të Bordit të Federatës,
- Udhëheqja me mbledhjet e Bordit të Federatës,
- Mënyra e aprovimit të vendimeve, të konkluzioneve dhe të qëndrimeve të Bordit të Federatës,
- Mënyra e emërimit të sekretarit të përgjithshëm të Federatës ,
- Mënyra e informimit për punën e Bordit të Federatës etj.

2. PËRGADITJA DHE CAKTIMI I MBLEDHJËS SË BORDIT

Neni 2.

Mbledhjet e Bordit të Federatës mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Neni 3.

Mbledhjet e rregullta e Bordit të Federatës i thërret Kryetari i Bordit, në mungesë të tij nënkryetari.

Neni 4.

Mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit të Federatës mund të thirret:

- me kërkesën e Kryetarit të Bordit,
- me kërkesën e më së paku një të tretës (1/3) së anëtarëve të Bordit,
- me kërkesën e Këshillit Mbikëqyrës

Neni 5.

Mbledhja e jashtëzakonshme mund të vendos vetëm për çështjet për të cilat është thirrur.

Neni 6.

Mbledhjen e Jashtëzakonshme duhet ti therras kryetari në afat prej 10 ditësh, prej ditës së marrjes së kërkesës, si dhe iniciuesi i procedurës përkatësisht anëtari i Bordit.

Neni 7.

Mbledhjet e Bordit janë publike, përveç nëse Bordi nuk vendos ndryshe.



Neni 8.

Mbledhjet e Bordit të Federatës mbahen sipas nevojës, por më së paku një herë në tre muaj.

Neni 9.

- Kohëzgjatja e mbledhjes së Bordit të Federatës mvaret nga rendi i ditës së aprovuar nga ana e Bordit, mirëpo në asnjë rast nuk mund të zgjat më tepër se katër (4) orë.
- Asnjë anëtar i Bordit nuk mundet me marrë fjalën më tepër se dy herë, për çdo pikë të rendit të ditës.

Neni 10.

Ftesa për mbledhjen e Bordit të Federatës duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, duhet t'u dërgohet anëtarëve të Bordit më së paku shtatë (7) ditë para mbledhjes, së bashku me materialet për shqyrtim.

3. MËNYRA E PUNËS SË BORDIT

Neni 11.

- Mbledhjen e Bordit të Federatës e hapë dhe e drejton Kryetari i Bordit.
- Në mungesë të Kryetarit, mbledhjen e Bordit të Federatës e drejton nën kryetari ose njëri nga anëtarët e Bordit, të cilin e cakton vetë Bordi i Federatës.

Neni 12.

Mbledhja e Bordit të Federatës mbahet nëse në mbledhje marrin pjesë gjashtë apo më shumë anëtarë të tij. Në të kundërtën mbledhja shtyhet dhe konvokohet rishtas.

4.VENDOSJA NË BORD

Neni 13.

- Mbas konstatimit se ekziston kuorumi, rendin e ditës e propozon Kryetari i Bordit, kurse aprovimi i rendit të ditës bëhet nga anëtarët e Bordit me ngritje të dorës.
- Secili anëtar i Bordit ka të drejtë të propozojë plotësimin ose edhe ndryshimin e rendit të ditës, për të cilën gjë vendos Bordi i Federatës.
- Në qoftë se ka propozime për ndryshim ose plotësim të rendit të ditës, Bordi i Federatës së pari vendos për këto propozime e mandej aprovon rendin e ditës.
- Nëse votohet atëherë votimi bëhet me vota të hapura.

5. PROCESVERBALI I BORDIT

Neni 14.

- Në mbledhjet e Bordit të Federatës mbahet procesverbali. Procesverbalin e mban sekretari i Federatës.



FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR

- Procesverbali, i cili përveç tjerash patjetër duhet të përmbajë vendimet eventuale të Bordit, miratohet në mbledhjen e ardhshme.
- Mbas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryetari i Bordit dhe procesmbajtësi.

Neni 15.

- Mbas përfundimit të diskutimeve për secilin propozim që parashtrohet në mbledhje, votohet në Bordin e Federatës
- Secili anëtar i Bordit ka vetëm një votë në Bordin e e Federatës.
-

6. MBAJTJA E RENDIT NË BORD

Neni 16.

- Anëtarët e Bordit të e Federatës që dëshirojnë të diskutojnë, këtë të drejtë e realizojnë me lejen e Kryetarit të Bordit ose të kryesuesit të mbledhjes.
- Diskutuesi gjegjësisht anëtar i Bordit të e Federatës ka të drejtë të diskutojë vetëm për atë çështje që është në rend të ditës.
- Nëse largohet nga pika e rendit të ditës kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë t'ia ndalë diskutimin.

7. VENDOSJA NË BORD

Neni 17.

- Bordi i Federatës mund të marr vendime të plotëfuqishme në qoftë se në mbledhje marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve të Bordit.
- Vendimet e Bordit të e Federatës janë të obligueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e e Federatës.

Neni 18.

- Vendimet në Bordin e Federatës merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, përveç kur një vendimmarrje rregullohet ndryshe me Statutin e Federatës. Në rast të numrit të barabartë të votave “për” dhe “kundër” vendos vota e Kryetarit të Bordit gjegjësisht të kryesuesit.
- Secili anëtar i Bordit të Federatës mund të abstenojë prej votimit, për të cilën çështje ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 19.

Votimi në mbledhjet e Bordit të Federatës bëhet me vota të hapura. Në qoftë se çështja është e rëndësishë së veçantë dhe Bordi mendon se votimi duhet të bëhet me vota të fshehta, atëherë veprohet sipas vendimit të shumicës.



8. ZGJEDHJA E SEKRETARIT TË FEDERATËS

Neni 20.

- Sekretarin e Përgjithshëm e emëron Bordi i Federatës me propozimin e Kryetarit.
- Në qoftëse anëtarët e Bordit të Federatës nuk pajtohen me propozimin e Kryetarit, atëherë Kryetari ose ndonje anëtarë i bordit ka të drejtë të propozojë një individ tjetër, për të cilin arrihet konsensusi.
- Votimi për emërimin e sekretarit të përgjithshëm bëhet me vota të hapura, përveç nëse Bordi i Federatës nuk vendos ndryshe.

Neni 21.

Sekretari i përgjithshëm emërohet me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.

Neni 22.

Sekretar i përgjithshëm i Federatës mund të zgjedhet vetëm personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Kosovës,
- është anëtar i Shoqatës përkatëse komunale,
- ka kualifikimin e lartë profesional,
- është personalitet i moralshëm dhe pedagog i dalluar me aftësi të dëshmuara profesionale, organizative dhe menagjuese.

Neni 23.

Sekretari i Përgjithshëm me Federatës themelon marrëdhënie pune me gjysmë norme me pagesë, me kontratë në afat të caktuar, në bazë të Ligjit të Punës të Kosovës.

Neni 24.

- Bordi i Federatës mund të formojë trupa punues (Këshilla dhe Komisione) të përhershme dhe të përkohshme.
- Këshillat dhe Komisionet për punën e tyre i përgjigjen Bordit të Federatës.

Neni 25.

Trupat e përhershëm dhe të përkohshëm të Bordit të Federatës janë:

- Komision Mbikëqyrës,
- Komision Profesional,
- Komisioni për marketing dhe kontakte me mjetet e informimit.

Neni 26.

- Kërkesat, ankesat ose propozimet që parashtrajnë anëtarët e Federatës, Bordi duhet t'i shqyrtojë në afat kohor prej dy (2) javësh.
- Vendimi ose konkluzioni i Bordit të Federatës duhet t'i dorëzohet anëtarit të Federatës në afat prej një (1) muajsh, në formën e shkruar.



Neni 27.

Për punën e vet Bordi i Federatës rregullisht informon opinionin publik, e në veçanti anëtarët e rregullt të Federatës. Informimi bëhet nëpërmjet mjeteve të informimit, buletineve, raporteve, vjetare etj.

Neni 28.

Anëtarët e bordit të cilët janë të komunave perkatësisht, regjioneve tjera duhet t'ju kompenzohet udhëtimi i ardhjes në Prishtinë.

9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 29.

- Kjo Rregullore konsiderohet e aprovuar nëse për të votojnë dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit të Federatës, që marrin pjesë në mbledhje.
- Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse edhe aprovimi i saj.

Neni 30.

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit të saj nga Bordi i Federatës.

Prishtinë

13.10.2022

Kryetari i FSSHRK-së

Adrian Telaku prof.